

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)***OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Riparim mirëmbajtje të linjave të sistemit të gazrave mjekësore, pajisjeve të tyre, kompresorëve të ajrit të komprimuar dhe pompave të ajrit të vakumuar, QSRT “Shefqet Ndroqi” Njesia Tirane, me afat 24 muaj.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
50800000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/Vlera e pritshme e Kontratave e parashikuar për periudhën **24** (njëzet e katër) mujore është: **3,522,866.67 (tre milion e pesëqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**

Çmimi mesatar për njësi: 525,300 (pesëqind e njëzet e pesë mijë e treqind)

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	Sasia
1	F.V.filtra të kompresorëve të ajrit antibakteriale	Copë	4
2	Riparim kompresorit të ajrit	Copë	4
3	F.V.valvul sigurie 11 bar tek kompresorët e ajrit	Copë	2
4	F.V kondesatori të kompresorët e ajrit	Copë	4
5	Riparim dhe tarim panelesh	Orë/pune	40
6	F.V.serpentine oksigjeni për bombolat tek paneli shkëmbimit automatik të oksigjenit	Copë	4
7	Kontroll dhe riparim i linjave të oksigjenit ,vakumit dhe ajrit	Orë/pune	60
8	Kontroll dhe mirëmbajtjen e valvolave të kompresorit të ajrit	Orë/pune	10
9	Riparim të tharësit të ajrit refrigerant	Copë	4
10	Riparim të pompave të vakumit	Copë	6
11	F.V.vaj për kompresorët e ajrit dhe pompave të vakumit sipas udhëzimeve të prodhuesit	Litra	50

12	F.V. filtër ajri antibakteriale për pompat e vakumit	Copë	6
13	F.V.valvula intercetimi	Copë	4
14	Zëvendësim të prizave të oksigjenit(të dëmtuara)tek hemodinamika	Copë	2
15	F.V. shkarkues kondesati automatik220v(lageshtie)	Copë	4
16	F.V. reduktore oksigjeni		6
17	F.V. bombol oksigjeni 10 litërshe të mbushur me oksigjen	Copë	6
18	F.V.lagështues 2-sh,me galixhant në formë sfere,300cc,të tipit afnor(standarti ekzistues është afnor në të gjitha pajisjet e oksigjenit) ose Ekuivalente	Copë	30
19	F.V. lagështues tek, me galixhant në formë sfere,300cc, të tipit afnor(standarti ekzistues është afnor në të gjitha pajisjet e oksigjenit) ose Ekuivalente	Copë	20
20	F.V.reduktorë oksigjeni te shkalles se dyte	Copë	2
21	Riparim-mirëmbajtje prizash oksigjeni,vakumi dhe ajri	Copë	120

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Q.S.R.T ”Shefqet Ndroqi”, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,ne të cilën është përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë e kriterëve plotësohet me kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të plotësuar më lart.

2.1.1 a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Këto kriterë gjejnë mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu këto kriterë gjejnë mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.1.2.a) Operatori duhet të ketë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.1.2.b) Operatori, duhet të ketë certifikatën ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” ose ISO 45001:2023 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” të përditësuara në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.1.2c) Operatori ekonomik ofertues në rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqesë autodeklaratë** që prodhuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi **është konform standarteve të cilësive ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe është e percaktuar në pikën a) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është vendosur në përputhje me pikat 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë tneni ë përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në pikën 1 të nenit 21 të Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” ndryshuar, në të cilën është e percaktuar se: Ministri përgjegjës për shëndetësinë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, pajis me autorizimin për tregtim prodhuesit, vendas ose të huaj, që kanë regjistruar biznesin në Shqipëri, dhe tregtuesit me shumicë e tregtuesit me pakicë të pajisjeve mjekësore”,

si dhe

Ky kriter i percaktuar ne piken a) dhe b)eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4 Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku percaktohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

(Shënim: *percaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2022; 2023; 2024 ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave të kësaj Procedure Prokurimi.**

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.**

****Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.**

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët*

ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”; dhe nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që: “Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor**”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara me poshte, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3. Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në pikën 2.10 / 2.14.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca

të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2: Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim te leshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi /MAH/ (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet te cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal dhe i vlefshëm ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 222/9 prot.,date 30.07.2025 për procedurën e prokurimit me “Riparim mirëmbajtje të linjave të sistemit të gazrave mjekësore, pajisjeve të tyre, kompresorëve të ajrit të komprimuar dhe pompave te ajrit të vakuumuar, QSRT “Shefqet Ndroqi” Njesia Tirane, me afat 24 muaj.”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 222prot, datë 03.06.2025, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose

një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (**ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014**). Ky kriter u mbështet edhe në **Rekomandimin nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **"Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik"**.

2.3.3 Oksigjeni mjekësor gaz që do të përdoret për mbushjen e bombolave duhet të jetë i regjistruar dhe OE konkurses ofertues duhet të jetë i autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqiten:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/
- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 222/9 prot., datë 30.07.2025 për procedurën e prokurimit me "Riparim mirëmbajtje të linjave të sistemit të gazrave mjekësore, pajisjeve të tyre, kompresorëve të ajrit të komprimuar dhe pompave të ajrit të vakuumuar, QSRT "Shefqet Ndroqi" Njesia Tirane, me afat 24 muaj.", nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 222prot, datë 03.06.2025 , dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit që kanë specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (**ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014**). Ky kriter u mbështet edhe në **Rekomandimin nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **"Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik"**.

2.3.4 Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, sipas percaktimeve ligjore.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 222/9 prot.,date 30.07.2025 për procedurën e prokurimit me “Riparim mirëmbajtje të linjave të sistemit të gazrave mjekësore, pajisjeve të tyre, kompresorëve të ajrit të komprimuar dhe pompave te ajrit të vakumuar, QSRT “Shefqet Ndroqi” Njesia Tirane, me afat 24 muaj.”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 222prot, datë 03.06.2025, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor I autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (**ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014**). Ky kriter u mbështet edhe në **Rekomandimin nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”**.

2.3.5:Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë: Kërkohet që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën deri në **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 5(pese) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët: 1(një) Inxhinier Mekanik,1(një) mekanik(pompist),1(një)elektracist,-2(dy)specialistë të pajisur me dëshmi aftësie profesionale për instalimet e enëve nën presion referuar ligjit Nr. 32/2016,me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi 5 – (pese) punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe
 - Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:
 - Minimumi 1 (një) inxhinier mekanik;
 - Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:
 - CV përkatëse;
 - Kopje e noterizuar e certifikatës ose dëshmisë përkatëse;
 - Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me inxhinierin mekanik.

- Minimumi 1 (një) mekanik (pompist);
 - Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:
 - CV përkatëse;
 - Kopje e noterizuar e certifikatës ose dëshmsë përkatëse;
 - Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me mekanikun (pompist)
- Minimumi 1 (një) elektrikist;
 - Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:
 - CV përkatëse;
 - Kopje e noterizuar e certifikatës ose dëshmsë përkatëse;
 - Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me elektrikistin.
- Minimumi 2 (dy) specialistë të pajisur me dëshmi aftësie profesionale për instalimet e enëve nën presion referuar ligjit Nr. 32/2016;
 - Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:
 - CV përkatëse;
 - Kopje e noterizuar e certifikatës ose dëshmsë përkatëse;
 - Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me specialistat e pajisur me dëshmi aftësie profesionale për instalimet e enëve nën presion referuar ligjit Nr. 32/2016.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

Argumentimi I kriterit

Ky kriter u vendos në mbështetje të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 222/9 prot., datë 30.07.2025 për procedurën e prokurimit me “Riparim mirëmbajtje të linjave të sistemit të gazrave mjekësore, pajisjeve të tyre, kompresorëve të ajrit të komprimuar dhe pompave të ajrit të vakumuar, QSRT “Shefqet Ndroqi” Njesia Tirane, me afat 24 muaj.”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 222prot, datë 03.06.2025, dhe u miratua nga anetaret e Njesise së Prokurimit që kanë specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Neni 41/4 b dhe c i VKM nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ky kriter është plotësuar në bazë të volumit të shërbimeve sipas zerave tepercaktuara në preventivin e shërbimeve, specialistët e mësipërm, janë përcaktuar në përputhje me listën e shërbimeve. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Dëshmia profesionale dhe dëshmia kualifikimit teknik, janë kërkuar nga AK për t'u siguruar në aftësitë e specialistëve për zbatimin korrekt të shërbimeve si dhe që këta specialistë kanë njohuritë e duhura për rregullat e sigurimit teknik në punë. Kerkohen profile të ndryshme: inxhinier mekanik, elektrikist, mekanik pompist dhe specialiste për enet në presion, të cilët nuk mund të zëvendësojnë njëri tjetrin. Kombinimi i këtyre roleve është i nevojshëm, një staf minimal prej 5 vetash që mbulojnë të gjitha kompetencat teknike për realizimin me sukses të shërbimeve.

1 (një) inxhinier mekanik;

Ky specialist është përgjegjës për:

- Vlerësimin teknik për pjesën mekanike të pajisjeve dhe zbatimin e standardeve inxhinierike për funksionimin e pajisjeve nën presion;
- Bashkëpunimin me ekipin teknik për të garantuar integritetin dhe efikasitetin e sistemit të shpërndarjes së gazrave mjekësore;
- Hartimin e raporteve teknike dhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me sistemet mekanike dhe komponentët e tyre.

1 (një) mekanik (pompist);

